



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 72/6 prot.

Tiranë, më 24.2.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 318, datë 3.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kujtim Luli
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 10.2.2021, është njoftuar vendimi nr. 318, datë 3.12.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Kujtim Luli, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 318, datë 3.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli, gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Luli, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si “ILDKPKI”), raportin e vlerësimit të figurës, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si “DSIK”) dhe raportin e vlerësimit profesional, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Kujtim Luli”, ka konstatuar për subjektin se:

- (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;
- (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka konstatuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit z. Kujtim Luli”.

2.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara dhe të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, si dhe rishikimit të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor, duke i përcjellë Komisionit raportin e hollësishëm të vlerësimit.

3. Komisioni, pasi ka kryer hetimin administrativ, në mënyrë të përmbledhur, për secilin kriter kontrolli, ka arritur në përfundimet si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë. [...]

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

3.2 Për kontrollin e figurës. [...] arrin në konkluzion se: (i) subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe të vërtetë për sa kohë i ka deklaruar veprat penale, për të cilat janë dënuar nipërit e tij; (ii) të gjitha procedurat hetimore dhe gjyqësore të qartësuara në dosjet gjyqësore penale të dy nipërve të subjektit, në asnjë rast, nuk kanë pasqyruar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as të tërthortë ndonjë indicie me sensin e ndërhyrjes së subjektit të rivlerësimit për të favorizuar të dënuarit në masën e dënimit për veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe dënuar; (iii) po ashtu, fakti që DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë dhe se përgjatë hetimit administrativ nuk rezultoi i provuar ndonjë informacion që ndikonte në pozitën e subjektit, me qëllim penalizimin e tij për vijimin e ushtrimit të detyrës, si dhe fakti që në të gjithë analizën e lartpërmendur nuk u provua denoncimi anonim, që mund të cenojë figurën e subjektit, trupi gjykues konkludon mbi provueshmërinë e përshtatshmërisë së subjektit për vijimin e ushtrimit të detyrës [...].

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, ... pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 [...].

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, trupi gjykues i Komisionit, me shumicë votash, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli, ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm vlerësimi për të tria kriteret, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kujtim Luli.*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 - 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

9. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 318/2020, çmon se ai është i cenusshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për

shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohet në vijim, ky ankim i referohet jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës, është organi i vetëm gjyqësor i procesit, që vendos për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit.

10. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si shkaqe për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, lidhur me: (i) deklarin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, mbi shpenzimet e shkollimit të djemve të tij në SHBA; (ii) pamjaftueshmërinë financiare të burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për përballimin e shpenzimeve; (iii) deklarin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për pasurinë në formën e likuiditeteve *cash* ndër vite; si dhe (iv) përfitimin nga subjekti i rivlerësimit i kredisë me kushte lehtësuese nga shteti për blerjen e pasurisë apartament me sip. 105,1 m², jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i shkaqeve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

12. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 318, datë 3.12.2020, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A Kontrolli i pasurisë

13. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14. Subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli, është bërë subjekt deklarues për herë të parë prej vitit 2003, duke plotësuar dhe dorëzuar në vijim, periodikisht pranë ILDKPKI-së, deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie.

15. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore dhe i deklaratës *Vetting*, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive, Komisioneri Publik vlerëson të ndalet fillimisht në konstatimin dhe analizën e shkakut të ankimit të deklaramit të pasaktë, të deklaramit të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit

dhe personave të lidhur me të, mbi shpenzimet e shkollimit të djemve të tij në SHBA, duke qenë se dhe nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se këto shpenzime përbëjnë dhe zërin kryesor të shpenzimeve gjatë gjithë periudhës së deklaramit.

16. Lidhur me deklaramin e pasaktë të shpenzimeve të shkollimit të djemve të subjektit të rivlerësimit

16.1 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore konstatohet se në vitet 2009-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime për shkollimin e dy djemve të tij në institucione arsimore private jashtë Republikës së Shqipërisë, konkretisht në Kosovë dhe në SHBA, si vijon:

16.2 Për djalin *.***, për shkollën e lartë në ***.***.***, dega shkenca kompjuterike**

16.2.1 Në Deklaratën Vetting, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesa për djalin ***.***, për shkollën e lartë në ***.***.***, Dega Shkenca Kompjuterike në periudhën 4-vjeçare, gusht 2009 – maj 2013. Vlera: **72.479 USD**. *Burimi i origjinës së pagesave janë të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes.*

16.2.2 Në DV-2009, në rubrikën “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë shkollë për djalin ***.***, për shkollën e lartë në ***.***.***, Dega Shkenca Kompjuterike, deri në 31.12.2009, në shumën 13.746 USD.

16.2.3 Në DV-2010, në rubrikën “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë shkollë për djalin ***.***, për shkollën e lartë në ***.***.***, Dega Shkenca Kompjuterike, deri në 31.12.2010, në shumën 14.453 USD.

16.2.4 Në DV-2011, në rubrikën “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë shkollë për djalin ***.***, për shkollën e lartë në ***.***.***, Dega Shkenca Kompjuterike, deri në 31.12.2011, në shumën 21.620 USD.

16.2.5 Në DV-2012, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë shkollë për djalin ***.***, për shkollën e lartë në ***.***.***, Dega Shkenca Kompjuterike, në shumën 19.369 USD.

16.2.6 Në DV-2013, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë shkollë për djalin ***.***, për shkollën e lartë në ***.***.***, Dega Shkenca Kompjuterike, në shumën 3.399 USD.

16.3 Për djalin *.***, për shkollën e mesme “***.***”, Prizren, Kosovë**

16.3.1 Në Deklaratën “Vetting”, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesa për djalin ***.***, për shkollën e mesme “***.***”, Prizren, Kosovë, në periudhën 2-vjeçare, gusht 2009 – qershor 2011: Vlera: 5.320 euro.

16.3.2 Në DV-2009, në rubrikën “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë shkollë për djalin ***.***, për shkollën e mesme “***.***”, Prizren, Kosovë, deri në 31.12.2009, në shumën 880 euro.

16.3.3 Në DV-2010, në rubrikën “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë shkollë për djalin ***.***, për shkollën e mesme “***.***”, Prizren, Kosovë, deri në 31.12.2010, në shumën 2.600 euro.

16.3.4 Në DV-2011, në rubrikën “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë shkollë për djalin ****.****, për shkollën e mesme “****.****”, Prizren, Kosovë, për periudhën janar – qershor 2011, në shumën 1.840 euro.

16.4 Për djalin ****.****, për Universitetin ****.***.****, dega “Menaxhim Biznes” në vitet gusht 2013 – maj 2015 dhe për shkollën e lartë të transferuar, ****.***.****, dega “Kontabilitet”, në vitet gusht 2015 – maj 2017

16.4.1 Në Deklaratën Vetting, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesa për djalin ****.****, për shkollën e lartë në ****.***.****, dega “Menaxhim Biznes”, në vitet gusht 2013 – maj 2015 dhe për shkollën e lartë të transferuar, ****.***.****, *****, dega “Kontabilitet”, në vitet gusht 2015 – maj 2017. **Vlera: 76.939 USD.** *Burimi i origjinës së pagesave janë të ardhurat nga paga ime, bashkëshortes dhe djalit ****.****, si dhe kursimet në vite nga këto të ardhura.*

16.4.2 Në DV-2013, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë shkollë për djalin ****.****, për shkollën e lartë në ****.***.****, dega “Menaxhim Biznes”, në shumën 13.864 USD.

16.4.3 Në DV-2014, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë familjare për djalin ****.****, për shkollën e lartë në ****.***.****, dega “Menaxhim Biznes”, në shumën 26.561 USD.

16.4.4 Në DV-2015, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pagesë familjare për djalin ****.****, për shkollën e lartë në ****.***.****, dega “Menaxhim Biznes”, viti i dytë akademik (gusht 2014 – maj 2015), në shumën 12.875 USD. Në të njëjtën deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pagesë familjare për djalin ****.****, transferuar në shkollën e lartë ****.***.****, *****, dega “Kontabilitet”, semestri i parë, viti i tretë akademik (gusht 2015 – maj 2016), në shumën 9.972 USD.*

16.4.5 Në DV-2016, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pagesë familjare për djalin ****.****, për shkollën e lartë në ****.***.****, *****, dega “Kontabilitet”, semestri i dytë, viti i tretë akademik (janar 2016 – maj 2016) në shumën 8.217 USD.* Në të njëjtën deklaratë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pagesë familjare për djalin ****.****, për shkollën e lartë, ****.***.****, *****, dega “Kontabilitet”, semestri i parë, viti i katërt akademik (gusht 2016 – dhjetor 2016), në shumën 9.972 USD.*

16.5 Komisioni, fillimisht, ka konstatuar mospërputhje midis deklaratave periodike dhe asaj “Vetting” lidhur me shumën e paguara për shkollimin e djemve ***** dhe ****.**** në SHBA, duke i kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Pasi ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, Komisioni i ka konsideruar ato bindëse dhe të pranueshme.

16.6 Komisioneri Publik, bazuar në analizën e akteve të administruara në dosje, deklaratat periodike vjetore, Deklaratën “Vetting”, përgjigjet dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të hetimit administrativ, si dhe lëvizjet e llogarive bankare të subjektit dhe personave të lidhur me të, jurisprudencën e Kolegjit, ndan qëndrim të ndryshëm për sa ka konkluduar Komisioni, pasi rezultoi se:

16.6.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe Deklaratën “Vetting” vetëm pagesat e kryera për llogari të universiteteve private në SHBA, ndërsa gjatë hetimit administrativ² ka deklaruar edhe shpenzime shtesë të cilësuar nga vetë ai si: *shpenzime për jetesë etj.*, në shumat 4.000 USD/vit të plotë dhe 2.000 USD për një semestër shkollor³ për secilin prej tyre, të pashoqëruara me dokumentacion ligjor justifikues.

16.6.2 Referuar akteve të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit mbi shpenzimet e fëmijëve për vitet 2009-2016, duket se për periudhën gusht 2009 - maj 2011 (viti i parë dhe i dytë i shkollimit të djalit ****.****), shumat e paguara për llogari të Universitetit ****.***.****, përveç tarifave të shkollimit përfshijnë dhe shpenzimet e jetesës në Kampusin Universitar (dhomë, sigurim shëndetësor, ushqim dhe libra), ndërsa për periudhën gusht 2011 e në vijim (për djalin ****.**** dhe nga viti 2013 e në vijim për djalin ****.****)⁴, duket se dokumentacioni i sjellë provon vetëm pagesat e tarifave të shkollimit dhe nuk provon mbulimin e shpenzimeve të ushqimit, shpenzimet për libra, transport dhe pagesa të tjera që nevojiten për jetesën e një studenti⁵.

16.6.3 Komisioneri Publik vlerëson se këto shpenzime shtesë, përveç se janë deklarative dhe të pashoqëruara nga ndonjë dokumentacion ligjor justifikues, nuk rezultojnë që të jenë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, përkundrejt detyrimit që ka pasur si subjekt deklarues, bazuar në nenin 2/7 të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, sipas së cilit: *“Shpenzim i deklarueshëm” është tërësia monetare e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues*. Po sipas nenit 4, germa “h” të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin e pasurive, shpenzimet e kryera përtej vlerës 500.000 lekë përpara vitit 2014 (2012-2014), dhe 300.000 lekë pas këtij viti.

16.7 Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarimin e shpenzimeve të kryera për shkollimin e djemve në SHBA, pasi nuk ka deklaruar dhe nuk ka vërtetuar me dokumentacion të plotë ligjor shpenzimet e jetesës. Pasaktësitë në deklarimin e shpenzimeve që lidhen me shkollimin në SHBA të dy djemve të subjektit të rivlerësimit, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në analizën financiare të të ardhurave dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të përdorura për mbulimin e tyre gjatë viteve 2009-2016, trajtuar më gjerësisht në vijim.

16.8 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë, referuar nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.⁶

17. Lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të të ardhurave nga burime të ligjshme të cilat kanë shërbyer në përballimin e shpenzimeve

² Në përgjigje të Pyetësorit nr.1, datë 3.7.2019.

³ Rezultojnë se 2 vitet e para, djali ****.**** ka qëndruar në Kampus dhe fatura e paguar nga subjekti i rivlerësimit ka në kostot e parashikuara dhe kostot e qëndrimit, ushqimit dhe pagesës së librave.

⁴ Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti nga ****.***.**** (*****), ****.**** dhe ****.**** mbi detajet e pagesave.

⁵ Gjatë hetimit administrativ, në pyetësorin nr. 8, subjekti i rivlerësimit deklaroi se fëmijët jetojnë në banesa më qira, duke filluar nga muaji gusht 2011 e në vijim, shpenzime të cilat janë përfshirë në analizën financiare të viteve respektive.

⁶ Vendim i Kolegjit (JR) nr.19/2019, prg.76-79.

17.1 Nga analiza financiare, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2011 – 2012, ka kryer shpenzime familjare, të cilat janë më të larta në raport me të ardhurat, duke rezultuar në pamundësi financiare për mbulimin e tyre nga burime të ligjshme, në shumën - 768.731 lekë, e për pasojë, i ka kaluar subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

17.2 Në prapësimet e tij, subjekti ka pretenduar rishikimin e disa zërave: (i) shpenzimet e jetesës së fëmijëve në SHBA; (ii) shpenzimet e udhëtimit; (iii) shpenzimet e akomodimit sipas kalendarëve të viteve akademike të vënë në dispozicion; (iv) si dhe rishikimin e kostove të shkollimit, duke iu referuar konvertimit të vlerës lekë/USD me kursin më të ulët të periudhave të pagesës. Në përfundim të prapësimeve, subjekti ka deklaruar se: [...] *në vitet 2003 – 2016 të gjitha shpenzimet familjare të deklaruarat i kam përballuar me të ardhurat e mia, bashkëshortes dhe kontributin e fëmijëve, nga burimet e ligjshme të deklaruarat, duke menaxhuar të ardhurat dhe kursimet në mënyrën më ekonomike të mundshme [...].*

17.3 Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka pranuar dhe rishikuar analizën e tij financiare vetëm për zërin e shpenzimeve të akomodimit, sipas kalendarëve të viteve akademike dhe të deklaratës së thjeshtë shkresore, të nënshkruar nga e afërmja e subjektit, ***.***, e cila ka deklaruar se djali i subjektit të rivlerësimit ka qëndruar pa pagesë te kjo e fundit pas përfundimit të vitit akademik. Komisioni ka konkluduar se balanca e re negative është në shumën – 694.654 lekë, balancë e cila nuk vlerësohet si masë penalizuese në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, parë kjo edhe në harmoni me veprimet konkludente të subjektit, për të qenë i vërtetë dhe i saktë në deklaratimet e tij.

17.4 Komisioneri Publik, në analizë të akteve dhe provave të administruara në dosje, ka vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, lidhur me: (i) periudhat e analizuarat dhe (ii) zërat e përfshirë në analizën financiare, si më poshtë argumentuar:

17.4.1 *Për periudhat e analizuarat:* Nga verifikimi i pasqyrave të lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, si dhe provave të paraqitura nga subjekti, rezulton se pagesat e shkollimit të dy djemve, gjatë periudhës 2009-2016, janë kryer kryesisht nëpërmjet transfertave nga llogaritë bankare në USD të subjektit dhe djalit të tij (***.***) pranë ***, shuma të cilat janë depozituar në *cash* nga subjekti i rivlerësimit⁷. Krahas këtij fakti, rezulton se Komisioni, në analizë të burimeve të ligjshme financiare që kanë shërbyer për të mbuluar shpenzimet vjetore, ka kryer analizën financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet e çdo viti kalendarik, duke përfshirë gjithë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës nga 1 janari deri në 31 dhjetor të çdo viti.

⁷ ***, me shkresën nr.*** prot., datë ***.10.2019, ka vënë në dispozicion të hetimit lëvizjet e llogarive bankare të subjektit, dokument nga i cili ka rezultuar se subjekti, gjatë periudhës 2009-2014, ka depozituar në *cash* në total 87.738 USD, shuma të cilat më pas janë transferuar për të kryer pagesat e shkollimit. *** **Bank**, me shkresën nr.*** prot., datë ***.10.2019, ka vënë në dispozicion të hetimit lëvizjet e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nga e cila ka rezultuar se në llogarinë dyemërore të bashkëshortes së subjektit dhe djalit ***.***, në datat ***.6.2009 dhe ***.6.2009, janë depozituar në *cash* shumat 7.000 euro dhe 9.000 euro, të cilat janë tërhequr më pas në datat ***.7.2009 dhe ***.3.2010, dhe janë deklaruar nga subjekti të përdorura për pagesat e shkollimit të fëmijëve. *** **Bank**, me shkresën nr.*** prot., datë ***.12.2019, ka vënë në dispozicion të hetimit lëvizjet e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit nga ku rezulton se ky i fundit ka depozituar në *cash* shumat 500.000 lekë në datën ***.4.2013 dhe 700.000 lekë në datën ***.7.2013.

17.4.2 Komisioneri Publik, nisur nga rrethanat e vërtetuara se shpenzimet e shkollimit të fëmijëve janë një nga zërat me peshë të konsiderueshme në shpenzimet vjetore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, vlerëson se analiza financiare do të duhej të ishte kryer duke iu referuar kohës së depozitimit të shumave në *cash* në llogaritë bankare të subjektit.

Për zërat e përfshirë në analizën financiare të Komisionit

17.5 Të ardhurat: Nga verifikimi i akteve në dosje, lidhur me të ardhurat e analizuara, rezulton se Komisioni ka përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve ndër vite, të ardhurat e deklaruara të përfituara nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit⁸ nga punësimi në shoqëritë “****” sh.p.k, “****” sh.p.k., dhe “****.****” sh.p.k. Për këto të ardhura, megjithëse janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, si dhe në atë “Vetting”, nuk është depozituar dokumentacion mbështetës (*kontrata punësimi apo dokumentacion financiar për të provuar pagesat e deklaruara*).

17.5.1 Gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion sipas të cilit rezulton se marrëdhëniet midis palëve janë rregulluar me kontrata të thjeshta shërbimi (pa noter), me afat një vjeçar, në të cilat përcaktohet pagesa neto mujore dhe detyrimi për pagesën e tatimit në burim i takon klientit (shoqërive si më sipër).

17.5.2 Nga verifikimi i llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë, nuk rezultojnë pagesa të kryera nga këto shoqëri. Subjekti, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, ka deklaruar se pagesat janë arkëtuar me mandat-pagesa pranë shoqërive.

17.5.3 Nga korrespondenca e Komisionit me organet tatimore ka rezultuar se nuk ka konfirmim për pagesën e detyrimeve tatimore, me emërtimin: *konfirmim për pagesë të tatimit* në emër të individit ****.****.

17.5.4 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, ka vënë në dispozicion vërtetime të lëshuara nga shoqëritë e mësipërme, të cilat pranojnë pagesat ndaj bashkëshortes së tij dhe pagimin e detyrimeve tatimore për këto pagesa, si dhe disa akte nga organet tatimore⁹.

17.5.5 Në analizë të akteve të administruara, bazuar në dispozitat e aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik vlerëson se, vetëm pagesa e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e siguruar nga punësimi në shoqërinë “****.****” sh.p.k., për vitet 2009 dhe 2011, mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, edhe pse nga verifikimi i të dhënave të sistemit TIMS rezulton se bashkëshortja e

⁸ Në shumat 1.400.000 lekë për vitin 2009; 1.000.000 lekë për vitin 2011; dhe 300.000 lekë për vitin 2012.

⁹ Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me shkresë nr.*** prot., datë ***.6.2020, konfirmon se shoqëria “****.****” sh.p.k. ka paguar tatim në burim në shumat, respektivisht: 76.500 lekë për vitin 2009 dhe 676.548 lekë për vitin 2011; Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresë nr.*** prot., datë ***.6.2020, konfirmon pagesa të kryera nga z.***.***, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., ka paguar tatim në burim në shumat 33.796 lekë datë ***.4.2009 dhe 17.719 lekë në datë ***.8.2013; Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, me shkresë nr.*** prot., datë ***.6.2020, konfirmon se lidhur me tatimpaguesin “****” sh.p.k., pagesat e kryera për tatim në burim nga krijimi deri në 31.12.2014, në total janë paguar 312.944 lekë.

subjektit, për periudhën ***.9.2009 deri në ***.12.2009, ka qenë jashtë Shqipërisë dhe transaksionet e pagesave nuk provohen me dokumentacion provues.

17.5.6 Komisioneri Publik, për të ardhurat e deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit si të përfituara nga shoqëritë “****” sh.p.k., dhe “****” sh.p.k., vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga subjekti nuk provon pagesën e detyrimeve tatimore, në mënyrë që ato të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për arsytet si më poshtë:

(i) Referuar shkresës nr.*** prot., datë ***.6.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, mbi tatimet e paguara nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., shuma e paguar në datën ***/4/2009 rezulton se është pagesë e kryer përpara realizimit të shërbimit, pasi kontrata me këtë shoqëri ka nisur në janar të vitit 2009, duke i shtrirë efektet deri në dhjetor të këtij viti, dhe konfirmimi për pagesën e tatimit në burim, në prill të vitit 2009, përveç se nuk identifikon se kujt i përket, nuk përputhet me kushtet e kontratës së dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit.

(ii) Referuar shkresës nr.*** prot., datë ***.6.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, mbi tatimet e paguara nga shoqëria “****” sh.p.k., rezulton se tatimi i konfirmuar i takon periudhës që nga krijimi i shoqërisë (viti 1999 sipas dokumentacionit në QKB) e deri në datën 31.12.2014. Shuma e tatimit të paguar nuk duket se i korrespondon pagesës së realizuar në emër të bashkëshortes së subjektit, duke nisur dhe nga fakti se, referuar të dhënave të depozituara nga kjo shoqëri në QKB, për vitin 2012, nuk rezulton që në pasqyrat financiare të depozituara të jenë regjistruar të ardhura dhe shpenzime të aktivitetit.

17.5.7 Nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni, duket se janë përfshirë në të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe disa shuma të kredituara në llogarinë bankare të saj pranë *** Bank, kreditime me përshkrimin: “*TRN FROM *** SHPK*”. Këto të ardhura nuk rezultojnë as të jenë deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore 2008 dhe 2009, dhe në atë “Vetting” dhe as nuk rezulton të jetë hetuar nga Komisioni në drejtim të pagesës së detyrimeve tatimore për këto të ardhura, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme, referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, duke mos u verifikuar kështu, asnjë nga kushtet kumulative të kësaj dispozite, sikundër orienton jurisprudenca e Kolegjit.

17.6 Kursimet në cash. Rezulton se në Deklaratën “Vetting” (dorëzuar në ILDKPKI, në datën 26.1.2017), subjekti i rivlerësimit *nuk ka deklaruar kursime në cash*. Ndërsa në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie (deklarata e parë, dorëzuar në ILDKPKI, datë 20.3.2004), rezulton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar dy herë “Formularin A-5/ Likuiditete” (f. 8), ku në njëjën prej kopjeve ka deklaruar: “*Shuma cash 3 milion lekë me burim të ardhurat nga paga dhe honoraret e deklaruar*”, ndërsa në kopjen tjetër ka deklaruar: “*2 milionë lekë gjendje cash me burim të ardhura nga paga dhe honoraret e deklaruar*”.

17.6.1 Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e subjektit deklarues, në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie (dorëzuar në ILDKPKI, datë 21.3.2004), në “Formularin A-5/Likuiditetet”, ka deklaruar: “*Gjendje cash 3 milion lekë, me burim të ardhura nga paga dhe honoraret e deklaruar*”.

17.6.2 Referuar procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI, më datë 18.3.2016, i pyetur mbi burimin e kursimeve në *cash* të deklaruara në DV-2003, në shumën 3.000.0000 lekë¹⁰, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] *Burimi për krijimin e kësaj vlere janë kursimet nga viti 1991 nga puna ime si prokuror, si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë në vitet 2000-2003 dhe në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2002-2003 [...].*

17.6.3 Gjatë hetimit administrativ¹¹, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime në lidhje me likuiditetet *cash* dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] *Nisur nga gjendja/formulimi jo i plotë dhe i paqartë në rubrikën “burimi”, të formularit më sipër të vetëdeklarimit të pasurisë, fillimisht në deklaratën për vitin 2003 në Formularin A-5 “Likuiditete” (faqe 8), në rubrikën “Vlera në milion lekë ose valutë”, kam deklaruar shifrën 2 milionë, që është vlera e kursyer nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes nga puna, honoraret e botimet, gjatë vitit 2003... Gjendja cash që kisha, në shumën 3 milionë, me burim krijimi kursimet vit pas viti nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes nga puna, honoraret e botimet deri në vitin 2003. Këtë fletë të formularit A-5 të shtuar ia kam dorëzuar përfaqësuesit të inspektoratit të ulët në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili e ka vendosur në deklaratën për vitin 2003 me fletën e formularit A-5 me shumën 2 milionë, të cilën e kisha dorëzuar më parë [...].*

17.6.4 Komisioni ka kryer analizën financiare fillimisht për periudhën 1991-2002, mbi kursimin e deklaruar prej 3.000.000 lekë dhe, më tej, ka analizuar mundësinë e subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme kursimet e deklaruara në vlerën 2.000.000 lekë për vitin 2003 (duke konsideruar si gjendje kursimesh *cash* deri në fund të vitit 2003, shumën 5.000.000 lekë), nga e cila i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit mbulon me burime të ligjshme kursimet e deklaruara.

17.6.5 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, konstaton se ka mospërputhje në deklarim mbi gjendjen e kursimeve në *cash*, nga ana e subjektit të rivlerësimit, krahasuar me të njëjtin deklarim të bashkëshortes së tij për periudhën në fjalë. Nga ana tjetër, edhe argumenti i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për shtimin e një formulari (f. 8 e deklaratës), me qëllim për të rideklaruar kursimet në *cash*, nuk qëndron, pasi në formularët e depozituar nuk saktësohet koha e krijimit të këtyre kursimeve. Komisioneri Publik vlerëson si të mbështetur në prova vetëm deklarimin e parë të subjektit të rivlerësimit, në të cilin deklarohen kursime në *cash* në vitin 2003, në shumën 3.000.000 lekë.

17.6.6 Për sa i përket deklarimeve të mëtejshme të subjektit të rivlerësimit mbi kursimet në *cash*, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk kanë deklaruar asnjë ndryshim, shtim apo pakësim të kursimeve në *cash*, deri në DV- 2014. Në DV-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Gjendje cash me burim nga kursimet e të ardhurave të mia dhe të bashkëshortes të mbartura nga puna e deklaruar për vitin 2015, në shumën 1.000.000 lekë [...].*

¹⁰ Pyetja nr. 4: “Në DPF/2003 keni deklaruar gjendje cash në vlerën 3.000.000 lekë. Sqaroni burimin për krijimin e kësaj vlere nga ana juaj?”.

¹¹ Pyetësori nr. 3, datë 18.3.2020, pyetja nr. 9, “Në deklaratën tuaj periodike vjetore të vitit 2003, faqja 8 e kësaj delarate (Formulari A-5 Likuiditete) rezulton të jetë depozituar dy herë, por me shuma të ndryshme, përkatësisht 3.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë. Lutemi jepni shpjegimet tuaja mbi këtë fakt se cila nga këto vlera është e saktë?”.

17.6.7 Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 2004 – 2016, duke: (i) konsideruar të pandryshuar kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti, në vlerën totale prej 5.000.000 lekë deri në vitin 2015, vit në të cilin ka reduktuar këto kursime në vlerën e deklaruar nga subjekti, prej 1.000.000 lekë; si dhe (ii) analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet, duke shtrirë analizën për të gjithë vitin kalendarik, si dhe duke mbajtur parasysh gjendjen e konsiderueshme të kursimeve *cash*, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit që prej vitit 2003.

17.6.8 Komisioneri Publik çmon se, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë vlerën e likuiditeteve gjendje në *cash*, jashtë sistemit bankar në lekë ose valutë të huaj, si dhe çdo ndryshim të këtyre vlerave.

17.6.9 Nisur nga specifika e pasurisë: “*kursime në cash*”, deklarimi i saktë i tyre në deklaratat periodike vjetore, merr rëndësi, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë që ka gjetur interpretim edhe në jurisprudencën e Kolegjit. Në vendimin e tij, (JR) nr. 27, datë 22.10.2020, Kolegji arsyeton se: [...] *Në dritën edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit (Shihni vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019 etj.), në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private periodike vjetore, të cilat konsiderohen provë në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe së bashku me deklaratën “Vetting” përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit... ndërsa deklaratimet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit [në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016], analiza e deklaratës “Vetting” dhe e shpjegimeve të subjekteve në proces përkundër deklaratave periodike është esenciale në vlerësimin e krijimit të pasurive në analizë të mundësive të krijimit me burime të ligjshme [...].¹²*

17.6.10 Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndryshim, shtim apo pakësim të kursimeve në *cash* ndër vite në deklaratat periodike vjetore, e për rrjedhojë, deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ se *një pjesë e shpenzimeve për përballimin e shkollimit të fëmijëve, kanë si burim kursimet ndër vite*, nuk mbështeten në prova.

17.6.11 Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në DV 2004 – 2016. Komisioneri Publik, në analizimin e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, sikundër do të trajtohet në vijim, nuk ka konsideruar si burim kursimet në *cash*, për sa kohë që subjekti nuk ka deklaruar ndryshime për to, si dhe nuk i ka deklaruar ato si burim të shpenzimeve të kryera në deklaratimet periodike vjetore.

¹² Kolegji i Posaçëm i Apelit ka trajtuar disa vendime lidhur me deklarimin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të prg. 27; nr. 19/2019, në prg. 84; nr. 20/2019, në prg. 59 dhe nr. 29/2019, në prg. 31.

17.7 *Për shpenzimet*: Rezulton se për periudhën ***.9.2009 deri në ***.6.2010, kohë në të cilën bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka qëndruar në SHBA (me një periudhë shkëputje në datat ***.3.2010 - ***.3.2010), në Kampus së bashku me djalin ***, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka llogaritur shpenzime jetese në vlerën 5 USD/dita, shpenzime të cilat nuk gjejnë mbështetje në dokumentacion justifikues të depozituar nga subjekti i rivlerësimit apo dhe nga jurisprudenca e deritanishme.

17.8 Në vlerësim të sa më sipër, duke marrë në konsideratë: (i) tërheqjet në *cash* nga llogaritë bankare të subjektit dhe personave të lidhur me të, për periudhat 1 janar deri në momentet e depozitimit; (ii) shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare në periudhën e analizuar; (iii) shpenzimet e qëndrimit të bashkëshortes në SHBA për periudhat ***.10.2009 - ***.6.2010, në masën 50% (25 USD/ditë) të kostos ditore të përcaktuar nga Kolegji në jurisprudencën e deritanishme, për sa kohë nga subjekti i rivlerësimit nuk është provuar mbulim i kostove të plota; (iv) depozitimet në *cash* të shumave respektive të konvertuara me kursin e publikuar nga Banka e Shqipërisë në datat e depozitimit; (v) shpenzimet e udhëtimit për të njëjtën periudhë, si dhe (vi) çdo shpenzim tjetër të evidentuar nga analizimi i akteve në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme depozitimet si më poshtë:

- Depozitimi i shumës 15.000 USD, në llogarinë në ***, nga subjekti i rivlerësimit, datë ***.4.2009, nuk mbulohet me burime të ligjshme në vlerën – **772.368 lekë**;
- Depozitimi i shumave në total 16.000 Euro, në llogarinë në *** Bank, nga personat e lidhur, bashkëshortja dhe djali i subjektit të rivlerësimit, në datat *** dhe *** qershor 2009, nuk mbulohet me burime të ligjshme në vlerën – **2.084.335 lekë**¹³;
- Depozitimi i shumave: 4.000 USD në datë ***.3.2010, 2.000 USD në datë ***.6.2010 dhe 9.550 USD në datë ***.8.2010, në llogarinë e subjektit në ***, nuk mbulohen me burime të ligjshme në vlerën – **897.553 lekë**;
- Depozitimi i shumës 10.610 USD në datë ***.7.2012, në llogarinë e subjektit, në ***, nuk mbulohen me burime të ligjshme në vlerën – **340.589 lekë**.
- Depozitimet e shumave: 3.000 USD në datë ***.7.2013, 9.000 USD në datë ***.8.2013 dhe 1.900 USD në datë ***.8.2013 (analizuar së bashku për shkak të afatit të shkurtër të kohës së kryerjes së tyre) në llogarinë e subjektit në ***, nuk mbulohen me burime të ligjshme në vlerën – **1.053.166 lekë**.
- Depozitimi i shumës 8.000 USD, në datë ***.6.2014, në llogarinë e subjektit në ***, nuk mbulohet me burime të ligjshme në vlerën – **366.375 lekë**.

17.9 Krahas sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa depozitime në *cash*, respektivisht shumat prej 11.720 USD datë ***.1.2011; 3.415 USD datë ***.1.2013; 8.043 USD datë ***.1.2014, të cilat nuk mbulohen me të ardhura të ligjshme, nisur nga data e kryerjes së këtyre depozitimeve dhe fakti që subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi

¹³ Në përlogaritje është përfshirë periudha ***.4.2009 deri më ***.6.2009, përfshirë blerjen e automjetit në vlerën 600.000 lekë, në datën ***.6.2009. Lidhur me këto depozitime subjekti ka deklaruar gjatë hetimit se, pas maturimit, shumat e tërhequra janë përdorur për të përballuar shpenzimet e shkollimit të fëmijëve.

pakësim/ndryshim të gjendjes së kursimeve të disponuara dhe mosdeklarimi i këtyre kursimeve si burim të shumave të depozituara.

17.10 Në përlllogaritjen financiare nuk janë përfshirë shpenzimet shtesë të deklaruara nga subjekti gjatë hetimit administrativ, në shumat 2.000 USD – 4.000 USD për secilin prej tyre, të cilësuar prej tij: *për jetesë etj.*, pasi sikundër argumentuar dhe më sipër në trajtimin e shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve, këto shpenzime janë deklarative dhe nga aktet në dosje nuk evidentohet momenti i kryerjes së tyre. Përfshirja e këtyre shpenzimeve do të ndikonte në rritjen e pamjaftueshmërisë së konstatuar.

17.11 Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, ka rezultuar se *** Bank, me shkresë nr.*** prot., datë ***.10.2019, ka vënë në dispozicion të hetimit dhe një llogari dyemërore, të çelur në emër të bashkëshortes së subjektit dhe motrës së saj, nga ku rezulton se, në datën ***.8.2010, është depozituar në *cash* shuma prej 15.000 Euro, me përshkrimin: *Depoziton ***.***, të ardhurat e vajzës të tërhequra nga ***.* Kjo shumë ka qëndruar në depozitën dyemërore deri në datën ***.9.2014, datë në të cilën, sipas lëvizjeve të llogarisë, rezulton se kjo shumë është transferuar në një llogari rrjedhëse. Kjo depozitë nuk rezulton e deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në asnjë nga deklaratat periodike të viteve 2010-2014.

17.11.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimi i kësaj depozite janë të ardhurat e vajzës së motrës së bashkëshortes, rrethanë fakti e deklaruar dhe në përshkrimin e transaksionit bankar. Subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale të shtetasës ***.***, nr.***, datë ***.7.2012, në të cilën ajo ka shprehur gatishmëri për mbështetje financiare për shkollimin e djalit ***.***, si garanci për dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për shkollë¹⁴. Subjekti, gjithashtu, ka depozituar shkresën e *** Bank, të datës ***.5.2020, drejtuar bashkëshortes së tij, znj.***.***, në të cilën banka konfirmon se kjo e fundit ka qenë e autorizuar në llogarinë dyemërore, në emër të ***.*** dhe ***.***, deri në datën ***.6.2012, dhe se znj.***.*** nuk ka kryer asnjë veprim në këtë llogari, e cila është mbyllur në datën ***.9.2014 dhe fondet janë transferuar në llogarinë në emër të znj.***.***.

17.11.2 Komisioni i ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit, të mbështetura në faktin se: (i) burimi i krijimit të shumës së depozituar është cituar në momentin që është kryer veprimi; (ii) bashkëshortja e subjektit nuk rezulton të ketë kryer asnjë veprim në këtë llogari (derdhje, tërheqje apo transferim fondi); (iii) deklaratën noteriale e vitit 2012 (*madje në gjuhë të huaj*), e motrës së bashkëshortes së subjektit, ku shpreh gatishmërinë e saj për shkollimin e nipit, ***.*** në SHBA; si dhe (iv) transferimit të fondeve, në vitin 2014, në llogarinë e saj personale (***.***).

17.11.3 Për Komisionerin Publik, në këto rrethana, mbetet kontradiktore kryerja e këtij veprimi financiar, për sa kohë në vitin 2010, vetë subjekti i rivlerësimit, ka disponuar kursime të konsiderueshme në *cash*, sipas vetë deklarimeve të tij në procesverbalet e mbajtura në ILDKPKI, si dhe pretendimeve të parashtruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

¹⁴ Të njëjtin deklaram mbi këtë shumë subjekti ka dhënë dhe në procesverbalet e mbajtura në ILDKPKI, në vitin 2016. Subjekti ka deklaruar në Komision se është informuar nga shtetasja ***.*** se shuma ka qëndruar në llogarinë e saj deri në vitin 2019, kur është kryer një tërheqje pjesore nga vetë ***.***.

17.12 *Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk mbulon me të ardhura nga burime të ligjshme, depozitimet në cash në sistemin bankar, të përdorura për pagesat e shpenzimeve të shkollimit të dy djemve të tij, për periudhën 2009-2014, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.*

18. Lidhur me përfitimën e kredisë me kushte lehtësuese nga shteti për blerjen e apartamentit me sip. 105,1 m² në rrugën “*.***”, Tiranë**

18.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sip.105,1 m², në rrugën “***.***”, p.***, shk.***, ap.***, Tiranë, blerë me kontratë sipërmarrje nr.***, datë ***.7.2003 dhe me kontratën e shitblerjes nr.***, datë ***.11.2014, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me certifikatën me nr. pasurie ***, z. k.***, me sip. 93 m²”. *Burimi i deklaruar:* Kredia për strehim në Bankën e Kursimeve, në shumën 5.000.000 lekë, me afat shlyerje 25 vjet. Vlera 48.346 USD. Pjesa takuese 50%.

18.2 Në DV-2003, subjekti i rivlerësimit deklaron për herë të parë këtë pasuri: “Apartament 2+1, në fazën e ndërtimit, i porositur, sipas kontratës së sipërmarrjes, me investitorin dhe firmën ndërtuese. Sipërfaqja 105,1 m². Vlera: 48.346 USD. Burimi i krijimit: kredi për strehim në Bankën e Kursimeve, Dega Tiranë”.

18.3 Në DV-2005, subjekti deklaron: “Pasuri e paluajtshme e paregjistruar, një apartament me sipërfaqe 105,1 m² në rrugën “***.***”, pas ***, ap.***, Tiranë, pagesa me kredi, me kontratë sipërmarrje të vitit 2003 në emrin tim, hyrë në shtator 2005”.

18.4 Në DV-2014, subjekti deklaron: “Regjistruar pasuria e paluajtshme (deklaruar në vitin 2005 me kontratën e sipërmarrjes) me certifikatën e pronësisë nr.***, datë ***.12.2014, zona kadastrale ***, Tiranë, një apartament me sipërfaqe 93 m², rruga “***.***”, shk.***, kat.***, ap.***, Tiranë. Vlera: 48.346 USD”.

18.5 Në vlerësim të burimit të krijimit të kësaj pasurie, kredisë me kushte lehtësuese, nga aktet e administruara, ka rezultuar si më poshtë:

18.5.1 Me kërkesën nr.*** prot., datë ***.6.1999, Prokurori i Përgjithshëm i është drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave, ku kërkon që, në vijim të listës së emrave për të cilët vlerësohet se plotësojnë kushtet ligjore për të përfituar kredi për strehim, të përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit, z. K. Luli.

18.5.2 Subjekti i rivlerësimit, z. Luli, me kërkesën e datës ***.5.2003, i është drejtuar Degës së Bankës së Kursimeve Tirana 1, ku i kërkon kreditim në shumën 5.000.000 lekë, në përputhje me VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të Administratës së Lartë Shtetërore”, i ndryshuar me VKM-në nr. 695, datë 20.12.2000.

18.5.3 Me kontratë huaje për blerje banese me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.6.2003, lidhur me Degën e Bankës së Kursimeve Tirana 1, subjekti i rivlerësimit ka përfituar huan me kushte lehtësuese nga shteti, në shumën 5.000.000 lekë, me interes 3% në vit dhe të pandryshueshëm, me afat shlyerje 25 vjet. Për sigurimin e kësaj huaje, subjekti i rivlerësimit ka vendosur si garanci kolateral apartamentin (2+1) të vëllait, z.***.***.

18.5.4 Pranë bankës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kontratë sipërmarrje të datës ***.5.2003, të nënshkruar midis tij në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, përfaqësuar nga z.***.***, me objekt: porositje e një apartamenti të ndodhur në rrugën “****.***”, Tiranë, me vlerë 44.800 USD. Kjo kontratë është prishur më pas nga palët pa penaltete, referuar aktit noterial: “Anulim i Kontratës së sipërmarrjes”, pasi porositësi (subjekti i rivlerësimit) nuk ka qenë i kënaqur me plotësimin e kushteve të kontratës, duke marrë mbrapsht shumën prej 5.000.000 lekë¹⁵ në llogarinë e tij pranë ***.

18.5.5 Më tej, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e porositësit, ka nënshkruar kontratën e datës ***.7.2003¹⁶, me znj.***.***, në cilësinë e investitorit dhe shoqërinë “****” sh.p.k., në cilësinë e ndërtuesit, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit ka porositur apartamentin me sip. 105,1 m², ndodhur në rrugën “****.***”, për shumën 48.346 USD. Subjekti i rivlerësimit, shumën prej 5.000.000 lekë, pasi e ka konvertuar në shumën 41.050 USD, në datë ***.7.2003, nga llogaria e tij pranë ***.***.*** Bank, ia ka transferuar shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin: “pagesë kontrate sipërmarrje”. Referuar përmbajtjes së kontratës, kjo transfertë përfaqësonte këstin e parë të pagesës, ndërsa kësti i dytë do të paguhej me dorëzimin e apartamentit. Kjo marrëdhënie mes palëve është finalizuar me kontratën e shitblerjes me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.11.2014. Në nenin 3 të kësaj kontrate, palët shprehen se çmimi prej 48.346 USD është likuiduar në përmbushje të kushteve të kontratës nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2003, dhe se apartamenti është marrë në dorëzim nga subjekti në vitin 2005.

18.5.6 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ,¹⁷ ka pretenduar se detyrimi për këstin e dytë, në shumën 7.346 USD, i korrespondon shpenzimit të kryer prej tij gjatë viteve 2003, 2004 dhe 2005 për materialet e këtij apartamenti, referuar pikës III të kontratës së sipërmarrjes. Si burim i kësaj shume kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet familjare nga paga, të deklaruara gjatë këtyre viteve, si dhe vlera 600.000 lekë, e përfituar nga shitja e pasurisë së trashëguar nga babai në Shkodër¹⁸. Ndërkohë, në deklaratat periodike vjetore dhe atë “Vetting”, si burim krijimi i pasurisë deklarohet vetëm kredia në shumën 5.000.000 lekë, konvertuar në shumën 41.050 USD.

18.6 Komisioni, pasi ka vlerësuar rrethanat dhe faktet si më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar shpjegime dhe prova shtesë subjektit të rivlerësimit, pasi dukej se:

- (i) *Kredia në shumën 5.000.000 lekë nuk ishte përfituar në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të Administratës së Lartë Shtetërore” të ndryshuar;*
- (ii) *Subjekti, në deklaratën periodike, si dhe në deklaratën “Vetting” deklaroi si burim krijimi, kredinë në shumën 5.000.000 lekë, ndërsa gjatë hetimit administrativ, përveç kredisë, deklaroi si burim edhe kursimet familjare nga paga, si dhe vlerën 600.000 lekë, të përfituar nga shitja e pasurisë së trashëguar nga babai i tij, në qytetin e Shkodrës;*

¹⁵ Ky fakt konfirmohet edhe me anë të deklaratës noteriale me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2003, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁶ Kjo kontratë është vërtetuar nga noteri ***.***, nr.*** kol., datë ***.7.2003.

¹⁷ Referohuni në pyetësorin nr. 2, datë 3.2.2020.

¹⁸ Referuar kontratës shitje në rezervë, pasuri të paluajtshme me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2001.

(iii) *Subjekti në vitin 2003 nuk kishte deklaruar detyrimin në shumën prej 7.346 USD, ndaj shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k.*

18.7 Në përgjigje të barrës së provës, me anë të parashtrimeve për rezultatet e hetimit administrativ, të datës 14 tetor dhe 16 nëntor 2020, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se:

(i) *[...] Kredia është përfituar në zbatim të pikave 1, 2, 6, 7 e vijues të vendimit të KM-së nr.102, datë 5.3.1999, i ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 965, datë 20.12.2000, sipas vullnetit të shprehur në listën e miratuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, mbi kërkesën e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka vlerësuar meritat, nevojat dhe gjendjen e strehimit të deklaruar nga ana ime, dhe në shkresën (nr.*** prot., datë ***.6.1999), drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave... Në kuptim dhe interpretim të pikës 6 të këtij vendimi të ndryshuar (riformular), Këshillit të Ministrave, duke hequr togfjalëshit “...që nuk kanë banesë...” dhe “...për ato që duan shtesë sipërfaqe banimi” dhe zëvendësuar me togfjalëshin “... në përputhje me kërkesën e paraqitur nga funksionari”, ka hequr kushtet/kriteret për vlerën e kreditimit në varësi të gjendjes së strehimit dhe e ka lënë (vlerën e kreditimit) në përputhje me vullnetin e funksionarit në kërkesën e paraqitur prej tij. Në zbatim të pikës 7 të vendimit të KM-së nr.102, datë 5.3.1999, në Degën e Bankës së Kursimeve kam paraqitur të gjithë dokumentet e listuara në KM. Kërkesa ime drejtuar bankës për kreditim në vlerën 5 (pesë) milionë lekë është trajtuar dhe konfirmuar si e bazuar në ligj nga specialistët juristë dhe ekonomistë të Degës së Bankës së Kursimeve Tirana I [...];*

(ii) *[...] Diferenca e vlerës së apartamentit të porositur me vlerën e paguar të kredisë në dukje përbën gabim material në mosdeklarimin e vlerës shtesë që do të mbulonte blerjen e pasurisë, ndërsa në fakt sipërmarrësi/ndërtuesit apartamentin e porositur për blerje e kanë shitur në vlerën 41,000 USD ose 5.000.000 lekë, që i korrespondon vlera e kredisë e deklaruar. Kjo për faktin se, në zbatim të nenit III të kontratës sipërmarrjes ndërtuesi/sipërmarrësi më kanë kaluar mua të drejtën për blerjen e disa materialeve/pajisjeve në masën 15% të vlerës së kontratës ose në shumën 7.346 USD. ... Vlera e materialeve të ndërtimit të blera nga unë në vitet 2003, 2004 dhe 2005 kanë pasur burim krijimi të ardhurat nga paga dhe vlerën 600.000 lekë, të përfituar nga shitja e pasurisë së trashëguar nga babai, të deklaruara në deklaratat periodike 2003, 2004 dhe 2005, ndërsa shpenzimet për blerjen e materialeve, nisur nga fakti se nuk e kanë kaluar shumën/vlerën (5,000 dollarë) e parashikuar në shkronjën “c” të nenit 4, të ligjit nr. 9040, datë 10.3.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, në fuqi në kohën e kryerjes së këtyre shpenzimeve, nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore në vitet 2003, 2004 dhe 2005 [...].*

(iii) *[...] Në vitin 2003 nuk kam deklaruar detyrimin në shumën 7.346 USD, ndaj shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k., dhe investitorit, për arsytet e sqaruar më sipër, se me nenin III të kontratës shoqëria ndërtuese dhe investitori më ka njohur të drejtën që 15 % të vlerës totale të kontratës që i korrespondon kështu të fundit në vlerë 7.346 USD, materialet/pajisjet e shënuara në kontratë të bliheshin nga unë në cilësinë e porositësit, të drejtë të cilën e kam ushtruar në vitet 2003, 2004 dhe 2005, duke u bërë inekzistent ky detyrim ndaj sipërmarrësit/ndërtuesit [...].*

18.8 Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se, subjekti ka deklaruar në mënyrë konsistente se ka kërkuar kredinë me kushte lehtësuese, duke deklaruar se kishte një pasuri dhe se ka deklaruar, gjithashtu, edhe përbërjen e tij familjare. Në konkluzion, Komisioni ka vlerësuar se nuk ka rrethana që të penalizojnë subjektin në raport me përfitimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese. Subjekti

nuk ka shtuar burim të ri për krijimin e kësaj pasurie, thjesht ka deklaruar gjatë hetimit se çfarë të ardhurash ka përdorur për blerjen e materialeve/pajisjeve.

18.9 Komisioneri Publik, në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, ndan vlerësim të ndryshëm mbi përfundimet e arritura nga Komisioni për pasurinë apartament me sip. 105,1 m², pasi:

18.9.1 *Lidhur me përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese nga shteti*, referuar VKM-së nr. 102/1999, të ndryshuar, konstatojmë se megjithëse pika 6, e këtij vendimi, është ndryshuar nga VKM-ja nr. 695/2000, duke u hequr togfjalëshi: **“që nuk kanë banesë ...”**, si dhe **“për ata që duan shtesë sipërfaqe banimi”**, sikurse pretendohet nga subjekti i rivlerësimit dhe është pranuar nga Komisioni, këto kushte përfitimi kanë qenë ende në fuqi në pikën 2 të këtij vendimi. Në këtë pikë përcaktohet qartë se: **“Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të Administratës së Lartë Shtetërore të përmendur më sipër janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për shtesë sipërfaqe banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti”**.

18.9.1.1 Të njëjtat kritere i gjejmë edhe nëse i referohemi nenit 47 të ligjit të kohës nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: **“1. Prokurori ka të drejtë të përfitojë banesë me kredi me kushte lehtësuese kur nuk ka banesë ose sipërfaqe të banueshme banimi në rrethin ku punon. 2. Në rast se prokurori ka banesë në një rreth tjetër nga ai ku ushtron detyrën, ai përfiton sipas pikës 1 të këtij neni, por shuma e kredisë do të jetë sa diferenca ndërmjet vlerës së kredisë për banesën e re me vlerën e banesës që ka në pronësi”**.

18.9.1.2 Për sa më sipër, në çdo rast, përfitimi i kredive me kushte lehtësuese nga shteti, kushtëzohet nga dy elemente fakti: (i) mospasja e një banese, dhe në këtë rast përfitohej shuma 5.000.000 lekë, apo (ii) pasja e një banesë me sipërfaqe më të vogël nën normën për frymë, dhe në këtë rast përfitohej shuma 2.500.000 lekë.

18.9.1.3 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa arsyeton Komisioni, vlerëson se referuar akteve në dosje nuk evidentohet që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar pronësinë mbi apartamentin me sip. 55,9 m² në rrugën “***.***”, Tiranë,¹⁹ gjatë procedurës së përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti në shumën 5.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit në momentin e aplikimit dhe përfitimit të kredisë është trajtuar në kategorinë e subjekteve që nuk kanë shtëpi në pronësi. Për rrjedhojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredinë në kundërshtim me kriteret e VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të Administratës së Lartë Shtetërore”, të ndryshuar. Kjo situatë e konstatuar faktike, parë në një vlerësim tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, mund të marrë rëndësi për qëllim të procesit të rivlerësimit.

18.9.2 *Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 105,1 m²*, ndodhur në rrugën “***.***”, Tiranë, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë

¹⁹ Përfituar me kontratën e privatizimit të vitit 1993.

deklarim të pasaktë në deklaratën “Vetting”, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016.

18.9.2.1 Deklarimi i subjektit, gjatë hetimit administrativ, se ka përdorur si burim për pagesën e detyrimit 7.346 USD, edhe të ardhurat nga paga dhe nga shitja e pasurisë në Shkodër nuk rezulton i mbështetur në prova, për sa kohë ato nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe atë “Vetting”. Edhe pretendimi i subjektit²⁰ në parashtrimet ndaj rezultateve të hetimit, se në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe në atë të “Vetting” ka deklaruar kredinë në vlerën 5.000.000 lekë (konvertuar në shumën 41.000 USD), si burim krijimi kryesor për blerjen e pasurisë së paluajtshme ap. me sip. 105,1 m², ndërkohë që vlera e pasurisë është 48.346 USD, dhe diferenca në dukje (7.346 USD) në këtë rast përbën gabim material, nuk qëndron.

18.9.2.2 Në këtë drejtim, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, mbajmë në konsideratë se sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, “Deklarimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë *paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*. Saktësia e deklaratave të subjektit të rivlerësimit është e rëndësishme për të kuptuar saktësisht gjendjen reale financiare të tij dhe për të vërtetuar nëse ai ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për krijimin e pasurisë.

18.10 Në përfundim, Komisioneri Publik, për pasurinë apartament me sip. 105,1 m², konstaton se subjekti i rivlerësimi ka kryer deklarim të pasaktë, referuar nenit 33, pika 5, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë përfituar kredi me kushte lehtësuese nga shteti jashtë kriterëve të përcaktuara ligjore.

19. Komisioneri Publik vlerëson se nga analiza e shkaqeve të këtij ankimi provohet se, për kriterin e kontrollit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke bërë të aplikueshëm nenin D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, nenin 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b” dhe nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016. Marrë për bazë këtë situatë faktike, së bashku me faktin se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi me kushte lehtësuese nga shteti jashtë kriterëve të përcaktuara ligjore, porë në një vlerësim tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, mund të vlerësohet se çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

20. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret dhe të ligjit të zbatueshëm, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë;

²⁰ Subjekti i referohet në këtë rast nenit III të kontratës sipërmarrjes, ku ndërtuesi/sipërmarrësi i kanë kaluar të drejtën për blerjen e disa materialeve/pajisjeve në masën 15 % të vlerës së kontratës ose në shumën prej 7.346 USD, të pretenduar prej tij.

21. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

22. Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4 dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016;

23. Komisioneri Publik kërkon, që në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, Kolegji të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 318, datë 3.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kujtim Luli.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA